

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, U.D. Gjyqtari Mbikëqyrës Jonuz Bugari, gjyqtarëve porot: Selami Gashi dhe Mustafë Cena, anëtar të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional Armond Omega, në çështjen juridike të propozuesit N. U. nga Rahoveci, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati G. Sh. nga Rahoveci, dhe propozueses A. U. e lindur K., e lindur në Beograd, tani me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokati M. B. nga Rahoveci, për shkak të zgjidhjes së martesës me marrëveshje, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor jo publik dhe zbatimit të provave, më 07.06.2017, morri këtë:**

## **A K T G J Y K I M**

**ZGJIDHET ME MARRËVESHJE** martesë në mes të propozuesit **N. U.** i lindur më ..., dhe propozueses **A. U.** lindur **K.**, e lindur më ..., martesë e lidhur më ..., në Zyrën e Gjendjes Civile në Rahovec, me nr. ser. **M ...**, me nr. rendor ..., dhe me numër të referencës **16|2012RM|16001**.

**Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale**

### **A r s y e t i m**

Propozuesit N. U. dhe A. U. e lindur K., në këtë gjykatë kanë parashtruar propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, kanë cekur se propozuesi pas qëndrimit një javor në Kosovë ka shkuar në Gjermani, disa herë kanë kontaktuar në telefon, ka insistuar disa herë që ajo të shkojë në Gjermani, edhe pse propozuesi ia ka rregulluar të gjitha letrat për bashkim familjar, por ajo nuk ka pranuar me pretekst se ai duhet të vijë në Kosovë, andaj duke pasur parasysh këtë fakt propozuesi dhe propozuesja pas bisedës kanë ardhur në përfundim dhe janë pajtuar që martesë të tyre të zgjidhet me marrëveshje.

Në lidhje me këtë çështje juridike gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor për datën 07.06.2017, në të cilën seancë është paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i propozuesit të parë, Av. G. Sh. dhe përfaqësuesi i propozueses së dytë Av. M. B..

Përfaqësuesi i autorizuar i propozuesit të parë ka deklaruar se ngel në tërësi si në propozimin e përbashkët të ushtruar për zgjidhjen e martesës pasi që më 30.08.2012 pranë zyrës së ofiqarisë në Rahovec, kanë lidhur kurorën, ku propozuesi ka qëndruar një javë në Kosovë dhe ka shkuar në Gjermani, disa herë kanë kontaktuar në telefon, ka insistuar disa herë që ajo të shkojë në Gjermani, por ajo nuk ka pranuar kështu që janë marrë vesh që me propozimin e përbashkët ta zgjidhë këtë martesë me marrëveshje, duke shtuar se nga martesë e tyre nuk kanë

fëmijë. Në fund i ka propozuar gjykatës që të bie aktgjykim për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, pasi që janë plotësuar kushtet ligjore.

Përfaqësuesi i autorizuar i propozueses së dytë deklaroi se ngel në tërësi si në propozimin e ushtruar të përbashkët për zgjidhjen e martesës me shkurorëzim, nga shkak se përkundër pëlqimeve dhe bisedave që janë bërë, që pas lidhjes së kurores të bashkëjetojnë propozuesi i rendit të parë dhe propozuesja e rendit të dytë nga shkaqet objektive, se propozuesi i rendit të parë jeton në shtetet të jashtme, ndërsa propozuesja e rendit të dytë në Kosovë, nuk kanë mundur të realizojnë bashkëjetesën faktike, në fund janë dakorduar që me marrëveshje ta zgjidhin me shkurorëzim martesën, duke shtuar se nga martesë e tyre nuk kanë fëmijë, e as nuk presin lindjen e fëmijës. Në fund i ka propozuar gjykatës që të aprovoi propozimin e tyre të përbashkët lidhur me prishjen e martesës me marrëveshje.

Gjykata, për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike ka bërë administrimin e provave dhe atë: ka bërë shikimin e çertifikatës së martesës M ..., me numër rendor ..., me numër të referencës 16|2012RM|16001, e lëshuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec, më 14.04.2017.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave, në bazë të bindjes së lirë, e duke u bazuar në nenin 8 të LPK-së, është konstatuar se propozimi i përbashkët i propozuesve për zgjidhjen e martesës me marrëveshje, është i bazuar dhe i njëjti është aprovuar.

Me shikimin në certifikatën e martesës me nr. serik M ... e lëshuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec, me 14.04.2017, vërtetohet se N. U. i lindur me ... në Rahovec, dhe A. K. e lindur me ... në Beograd, kanë lidhur martesë më datë ..., pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Rahovec.

Andaj në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë dhe duke u bazuar në dispozitat neneve 68, 69 dhe 84 të Ligjit mbi Familjen i Kosovës dhe nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mbështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**  
**C.nr. 149/2017, më 07.06.2017.**

**B. Profesional**  
**Armond Qmega**

**Kryetari i trupit gjykes**  
**Jonuz Bugari**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet ndërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit Divizioni Civil në Prishtinë.